

VENDIM
Nr. 220, datë 17.4.2019

**PËR KALIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË MEMALIAJ, TË PRONËS ME
NUMËR RENDOR 264, DHE PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 974, DATË
30.9.2009, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS
PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE,
SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË
BASHKISË MEMALIAJ, TË QARKUT TË GJIROKASTRËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, shkronja “gj”, 5, 8 e 17, të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi të Bashkisë Memaliaj, për njësinë administrative përbërëse Memaliaj, të pronës me numër rendor 264, sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi, për t’u përdorur për zgjerimin e varrezave publike të qytetit Memaliaj.

2. Prona e përmendur në pikën 1, të këtij vendimi, t’i shtohet listës së inventarit të pronave të paluajtshme, që i bashkëlidhet vendimit nr. 974, datë 30.9.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Memaliaj, të Qarkut të Gjirokastrës”.

3. Bashkisë Memaliaj i ndalohet të ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Agjencia Shtetërore e Kadastrës (Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme) dhe Bashkia Memaliaj për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUJTESHME SHTETERORE

(Per inventarizimin e pronave te vecanta)

(Mbeshtetur ne inventarin e pronave te vecanta te tipit Infrastrukture dhe sherbime publike

Per nje shtese ne listen perfundimtare tr transferimit te pronave te palujteshteme publike ,shteterore ,miratuar me V.K.M

nr.974 date 30.9.2009

Bashkia: Memaliaj

Identifikoi : Beqir Gjergji Specialist I Pronave Topograf

(emiri ,mbiemri, pozicioni zyrtar

Fusha e perdorimit te prones : Sherbime Publike (Varreza

Supervizioni : Violeta Kanushi .Pergj Zyres Zhvillimit Urban Kadastres

(emir,mbiemri,pozicioni i punes)

Aprovoi : Durim RROSHI Kryetar I Bashkise)

(emir,mbiemri ,pozicioni zyrtar, tel.firma .vula)

Nr Rend	A			B			C			
	Zona Kadaster Indeksi I hartes	Nr Pasurise	Lloji I Prones	Emri I Prones Adresa	Sip Totale e Prones (m2)	Nga Sip Totale Sa Ndertese (m2)	Fuksioni per te cilen Perdoret prona	Institucioni/Enti Me pergjegjisi administrative	Institucioni/Enti Perdorues Statusi juridik I perdorimit	Te dhena te tjera (Shenime te vecanata)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	
264	2646 ME-D-4	2/34	Truall	Truall Bashkia Memaliaj	2726		Sherbim publik per varreza	Bashkia Memaliaj	Bashkia Memaliaj	Kjo pasuri do te perdoret per varrezat publike,